

VENDIM
Nr. 35, datë 22.5.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE
NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KAVAJË SHA**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe në raportin nr. 64/2, datë 15.5.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator, konstatoi:

Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. i ka përfunduar afati i licencës në datën 15.3.2017 dhe ushtron veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura pa licencë nga Enti Rregullator i Ujit, në kundërshtim me nenin 15, pika 1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. ka detyrime të pashlyera të pagesës rregullatore ndaj Entit Rregullator të Ujit në vlerën 5 311 600 (pesë milionë e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë deri në datën 31.12.2017, të cilat burojnë nga kontratat mes Entit Rregullator të Ujit dhe Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a., datë 12.1.2009 dhe kontratës datë 26.7.2010.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a., për kundërvajtjet administrative:

- a) Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë;
- b) Mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator të Ujit.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani